



Përmbajtja

I. Konteksti	3
II. Përshkrimi i Punës	3
III. Kualifikimet dhe përvoja	4
IV. Procesi i Aplikimit.....	4
V. Afati për Aplikime.....	4

Titulli

Kontraktimi i një Kompanie për Video-Leksione për Projektin “EmpowHer”, Erasmus+

Kohëzgjatja

21 muaj me mundësi zgjatjeje

Vendndodhja

Tiranë, Shqipëri

Projekti *E.H - “EmpowHer” - ERASMUS-EDU-2024-VIRT-EXCH, Referenca e Projektit: 101193510* është një iniciativë e financuar nga programi Erasmus+ që synon fuqizimin e grave dhe vajzave përmes edukimit, zhvillimit profesional dhe mundësive të barabarta për pjesëmarrje në shoqëri. Ky projekt synon të mbështesë gratë e reja në marrjen e roleve udhëheqëse dhe forcimin e kapaciteteve të tyre në fushat profesionale dhe sociale.

I. Konteksti

Objekti i këtij kontrakti është prodhimi dhe ofrimi i **video-leksioneve cilësore dhe webinareve interaktive**, të cilat përmbushin standardet pedagogjike, teknike, të aksesueshmërisë dhe gjithëpërfshirjes, siç përcaktohen në **Methodological Guide for MOOC Preparation**.

II. Përshkrimi i Punës

1. Fusha e Punës

Kompania e kontraktuar do të jetë përgjegjëse për:

- Prodhimin e video-leksioneve trajnuese (secila me kohëzgjatje 60 minuta);
- Regjistrimin teknik, montazhin dhe post-produksionin e materialeve video;
- Integrimin e subtitrave dhe elementeve të aksesueshmërisë;
- Koordinimin e vazhdueshëm me konsorciumin e projektit.

2. Kërkesat Teknike

Video-leksionet duhet të:

- Jenë në format MP4, me rezolucion minimal 1080p;
- Kenë subtitra në anglisht dhe në gjuhën shqip;

Të ndjekin strukturën:

- Hyrje (çfarë do të mësohet),
- Konceptet kryesore,
- Shembuj praktikë / raste konkrete,
- Përmbledhje dhe thirrje për veprim.

3. Metodologjia

Kompania duhet të:

- Përgatisë skenarë të shkruar përpara çdo regjistrimi;
- Ndjekë modelet (templates) e ofruara në Canva, kur është e aplikueshme;
- Sigurojë përdorimin e gjuhës gjithëpërfshirëse dhe të ndjeshme ndaj barazisë gjinore;
- Dorëzojë materialet për shqyrtim dhe miratim të paktën dy javë përpara publikimit në platformën MOOC.

4. Produktet e Dorëzueshme

- Video-leksionet finale të edituara;
- Subtitrat e integruara ose skedarët e subtitrimit;
- Materiale mbështetëse shtesë, nëse kërkohen nga projekti.

III. Kualifikimet dhe përvoja

Kompania aplikuese duhet:

- Të jetë e regjistruar ligjërisht dhe aktive në fushën e prodhimit audiovizual, e-learning ose trajnimeve online.
- Të ketë të paktën 3 vite përvojë në prodhimin e videove.
- Të ketë përvojë në përdorimin e platformave digjitale për prodhimin e videove profesionale.
- Të demonstrojë aftësi në regjistrim, montazh dhe post-produksion video, si dhe integrimin e subtitrave.
- Përvoja në projekte të financuara nga BE/Erasmus+ përbën avantazh.
- Njohuri të shkëlqyera të gjuhës angleze.

IV. Procesi i Aplikimit

Kandidatët e interesuar duhet të dorëzojnë

- NIPT i agjencisë/ kompanisë
- CV e përditësuar e entitetit dhe stafit;
- Shprehje interesi, ku të përshkruhet qartë pse aplikuesi i përmbush kriteret dhe të përmenden përvoja të ngjashme;
- Kopje e diplomave/kualifikimeve;
- Dokumente të tjera mbështetëse.

V. Afati për Aplikime

Aplikimet duhet të dërgohen deri më datë 16.03.2026 ora 16:00 në adresën e e-mailit: info@rinia.gov.al

Agjencia Kombëtare e Rinisë (AKR)

"Rruga Naim Frashëri" nr 37, Tiranë, Shqipëri

Agjencia Kombëtare e Rinisë është një punëdhënës me mundësi të barabarta dhe inkurajon kandidatët me prejardhje të ndryshme të aplikojnë.

Shënim: Termat e mësipërme të referencës janë dhënë si një udhëzues i përgjithshëm dhe mund të jenë subjekt i modifikimit bazuar në nevojat në zhvillim të projektit.
